

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

E nderuara Kryesi e Xhamisë,
I nderuari imam i Qendres, Rejhan ef. Neziri
I nderuar kryetar K.M.SH. në Zvicër, Mehas ef. Alija
I nderuar kryetar i Kreuzlingenit me bashkpunëtor
I nderuar përfaqësues i FIDS-it
I nderuar Selver ef. Xhemaili
Të nderuar imam, hoxhollar ...
Të nderuar xhematli, të nderuar pjesëmarrës, vëllezër e motra!

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në emër të organeve dhe institucioneve të saj, në emër të Myftiut Naim ef. Ternava, t'ju drejtohem me një urim e falënderim të veçantë në gëzimin Tuaj në këtë manifestim të rëndësishëm dhe të shënuar për Ju, për popullatën, mërgimtarët dhe për besimtarët tanë, me rastin e shënimit të tridhjetë vjetorit të Qendrës Islame Shqiptare “ Hëna e re “ në Kreuzlingen të Zvicrës.

Të nderuar të pranishëm,

Zoti i Madhëruar dëshmoi:

“Xhamitë e Allahut i ndërtojnë (kujdesen dhe i mirëmbajnë) vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zeqatën e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë” (Et Tevbe: 18)

Profeti Muhamed thotë: "Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Ai do t'i ndërtojë atij një shtëpi në xhenet. (Buhariu)

"Nga veprat, sevapi i të cilave nuk ndërpritet edhe pas vdekjes janë: ndërtimi i një xhamie ." (Ibn Maxheh)

Nga këto shprehje Kuranore dhe thënieve të profetit Muhamed rezulton se ju të nderuar vëllezër dhe motra, keni një besim të fortë në Zotin Një, të gdhendur thellë në zemrat tuaja, këtë e dëshmon kjo qendër dhe shumë xhami të tjera të ndërtuara nga besimtarët.

Të nderuar pjesëmarrës.

Besimtari kudo që jeton dhe zhvillon jetën e aktivitetin e tij, ka nevojë të domosdoshme të ketë një vend të veçantë për adhurimin dhe madhërimin e Allahut të Madhëruar. Kjo i lehtëson edhe dhimbjet e kurbetit, meqë aty përveç që gjen prehjen shpirtërore me Zotin e botëve, takon edhe bashkëkombësit e vet, në mesin e të cilëve ndihet gati si në vendlindje.

Mësimet islame mbi emigrimin dhe përshtatjen e myslimanit në një truall të ri janë shumë të rëndësishme. Përderisa Islami urdhëron që vendlindja të duhet dhe të mos harrohet asnjëherë, në të njëjtën kohë, feja Islame urdhëron që myslimani të integrohet në shoqëritë në të cilat shpërngulet. Shembulli më i mirë i kësaj që themi është vetë shembulli i Muhamedit a.s., i cili në momentet e lëshimit të Mekës, i mallëngjyer e i mërzhitur, u kthye nga Meka dhe i thuri vargje dhimbjeje, duke u shprehur se:”... po mos të më kishin dëbuar

nga ti, asnjëherë nuk do të isha larguar vetë prej teje". Por, në të njëjtën kohë, me shpërnguljen e tij në Medine u përshtat në formën më të bukur me traditat dhe rendin e medinasve pa u prishur atyre mirëqenien, dhe pa i detyruar ata që të ndryshojnë traditat e veta dhe pa kërkuar prej tyre të ndryshojnë stilin e jetesës. Jemi të bindur se secili prej jush keni histori në momentin e emigrimit tuaj, që ndërlihet ngusht me emigrimin e profetit Muhamed.

Madje, puna e parë që bëri Pejgamberi a.s. ishte ndërtimi i xhamisë. Kjo xhami nuk ishte thjesht një vend faljeje dhe adhurimi, por një xhami me plot kuptimin e fjalës. Xhamia është një institucion që e vetëdijeson besimtarin në të gjitha fushat e jetës, xhamia është një shkollë, një universitet ku mësohet jeta krahas adhurimit të Zotit, një vend ku njerëzit gjejnë rehatinë shpirtërore dhe bashkë diskutojnë çështjet që i preokupojnë ata në përditshmërinë e tyre.

Përgjatë shekujve, xhamia ka luajtur rolin e vet në kultivimin e vlerave dhe zhvillimin e shoqërisë. Nga xhamitë rezultuan shumë shkencëtarë, mjekë, filozofë e dijetarë të mëdhenj që i mësuuan njerëzimit fjalën e drejtë të Zotit, dhe që i mësuuan se xhamia kultivon tolerancë, mirëkuptim dhe bashkëjetesë.

Falë lirisë së besimit dhe së drejtës për adhurim që shteti demokratik zviceran ua ofron të gjithë qytetarëve të tij, pa dallim kombi dhe përkatësie, mërgata Shqiptare gjetën lehtë mënyra të organizoheshin dhe të kryenin ritet e tyre fetare në vende të posaçme adhurimi. Sot, si fryt i kësaj lirie dhe të drejte, myslimanët shqiptarë gëzojnë këtë Qendër dhe dhjetëra të tjera në tërë Zvicrën.

Atëherë dua të falënderoj përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe të komunës së Kreuzlingenit, dhe përgjithësisht popullin zviceran për kontributin e dhënë në drejtim të komunitetit mysliman shqiptar dhe të tjerëve në Zvicër.

Xhamia përpos për kryerjen e namazit, shërben edhe si një qendër edukative-arsimore për fëmijët tanë shqiptarë që jetojnë në diasporë. Me një fjalë, ajo kultivon vlerat fetare dhe kombëtare, për të cilat populli ynë ka nevojë në vazhdimësi. Madje, xhamitë luajnë rolin e afrimit mes myslimanëve dhe rrezatojnë paqe, siguri, tolerancë, respekt edhe ndaj të tjerëve, për të jetuar të gjithë në paqe e lumturi.

Të nderuar pjesëmarrës dhe ju mërgimtarë të respektuar, ju siguroj se Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është shumë e përkushtuar që të forcojë dhe të shtojë komunikimin me xhamitë shqiptare në diasporë dhe me gjithë të tjerët, me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve në të mirë të mërgatës sonë.

Zoti ju ndihmoftë e ju ruajt! Urime dhe e gëzofshi 30 vjetorin e Qendrës!